



Raporti i monitorimit të integritetit në

Administratën Tatimore të Kosovës

shtator 2018 – shkurt 2019

Autorë:

Egzona Kozhani/Kastriot Berisha

Hulumtues:

Rrahman Ramaj/Amire Qamili

Redaktorë:

Visar Rushiti/Kreshnik Gashi

Lektura:

Perparim Isufi

Ekipi ligjor:

Arber Kadriu/Arbelina Dedushaj

E drejta e autorit © 2019. Democracy Plus (D+) dhe BIRN

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+ dhe BIRN.

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	04
Hyrje	05
Qëllimi i Raportit	07
Metodologjia e Monitorimit të Administratës Tatimore të Kosovës	08
Gjetjet Kryesore	09
Amnestia e shkeljeve	09
Mospërfilljet në deklarin e pasurisë	09
Mungesa e resurseve për të kontrolluar integritetin	10
Defektet teknike në Procedurë	10
Ripërtëritja e gabimeve	11
Sinjalizimi i dyshimeve dhe mbrojtja e sinjalizuesve	11
Testet e efektshmërisë së raportimeve dhe ankesave	12
Përmbledhje dhe analizë e vendimeve të Komisioni Disiplinor	12
Vendimi nr. 1/2018 kundrejt zyrtarit të mbledhjes së detyrueshme për vozitje nën ndikim të alkoolit	12
Vendimi nr. 2/2018 dhe nr. 4/2018 kundrejt tre zyrtarëve të një drejtorie rajonale të ATK-së për shqiptim të gjobës me vlerë zero euro	13
Vendimi nr. 3/2018 kundrejt menaxherit të drejtorisë rajonale për mungesën në punë pa paralajmërim	14
Vendimi Nr. 5/2018 kundrejt inspektorit për sjellje të keqe ndaj zyrtarëve tjerë të ATK-së	15
Vendimi nr. 6/2018 kundrejt inspektorit për keqpërdorim të detyrës zyrtare	16
Vendimi nr. 7/2018 kundrejt inspektorit për konflikt interesi dhe mos-shqiptim të gjobës për mungesë të arkës fiskale	16
Përmbledhje dhe analizë e vendimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave	20
Përmbledhje dhe analizë e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	21
Përfundime dhe Rekomandime	23
Shtojca 1: Strukturat nëpër të cilat kalon një procedurë disiplinore brenda dhe jashtë ATK-së	25
Shtojca 2: Vendimet e KPMSHC-së	29
Shtojca 3: Tabela e raportimeve	36

LISTA E SHKURTESAVE

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DSP	Divizioni i Standardeve Profesionale
KZKA	Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave
ZBNj	Zyra e Burimeve Njerzore
KPMSHC	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil
ZGJONA	Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime
TVSh	Tatimi në Vlerën e Shtuar
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Hyrje

Në raportet vendore dhe ndërkombëtare në vazhdimësi theksohet se ekonomia joformale në Kosovë është rreth 30 për qind të bruto produktit vendor (GDP), që përkthyer në shifra është diku 1.8 miliard euro në vit¹. Administrata Tatimore është njëra nga hallkat kryesore të luftimit të evazionit fiskal dhe shmangies së tatimeve në vend për të zvogëluar boshllëkun tatimor.

ATK së bashku me Doganën janë dy institucionet kryesore të cilat mbushin arkën e shtetit dhe rrjedhimisht të qenurit në këtë pozitë ka bërë që këto institucione të jenë edhe të brishta ndaj aferave të korrupsionit. Bazuar në hulumtimet e kryera nga UNDP rreth perceptimit të qytetarëve mbi nivelin e korrupsionit, ATK renditet si institucioni i nëntë në vend në të cilin qytetarët mendojnë se ka korrupsion. Raporti konstaton se ATK ka shënuar regres në perceptimin e qytetarëve të cilët për dallim nga viti 2017 e kanë ranguar më keq ATK-në në maj të vitit 2018. Megjithatë, sipas raportit të fundit të Pulsit Publik, në bazë të krahasimit në mes të muajve maj dhe nëntor 2018, ATK ka shënuar progres për 3.5% në uljen e perceptimeve të qytetarëve mbi praninë e korrupsionit në ATK duke bërë që ky institucion të rangohet si institucioni i pestë më pak i korruptuar në mesin e 14 institucioneve të përfshira në raport².

Ulja e besimit në ATK-në mund t'i atribuohet shumë faktorëve përfshirë rritjes së raportimeve të mediave për aferat korruptive brenda ATK-së, përvojave ditore të qytetarëve me mungesën e kuponëve fiskalë dhe tolerimeve të lojërave të fatit në vendet e ndaluara.

Me rreth 800 nëpunës, ATK i është ekspozuar vazhdimisht dyshimeve dhe aferave të korrupsionit, ndërsa vetëm gjatë vitit 2018 mbi 10 zyrtarë të këtij institucioni u përballën me hetime të prokurorisë për vepra penale.

Kosova për momentin ka një sistem tatimor ku Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) mbledhet në kufi nga Dogana e Kosovës duke orientuar kështu fokusin e mbledhjes së të hyrave kryesore nga Dogana. Ndërsa, ATK-ja e mbledh TVSh-në e brendshme, pra për vlerën e mallit që rritet prej hyrjes në kufi e deri te shitja te konsumatori i fundit. Standardet Evropiane Tatimore rekomandojnë që mbledhja e TVSh-së të bëhet brenda vendit në mënyrë që të shmanget barra për bizneset në kufi.

Si rrjedhojë, në vitet në vijim vendi do hyjë në një reformë të thellë të mbledhjes së taksave ku ATK do ketë rol të rëndësishëm në këtë proces.

Puna e Administratës Tatimore të Kosovës rregullohet kryesisht me dy ligje të cilat e ndikojnë raportin e saj me të punësuarit. Këto dy ligje përfshijnë Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Administratën Tatimore. Këto ligje përveç të tjerash rregullojnë formën e rekrutimit,

¹ Radio Evropa e Lirë, *Ekonomia jo-formale në Kosovë mbi 30 për qind* : <https://bit.ly/2Nra5En>

² UNDP, *Pulsi Publik XV, f. 16, shkurt 2019*: <https://bit.ly/2DYJM47>

mbikëqyrjes, transferimit dhe hetimit të zyrtarëve publikë të cilët kanë statusin e shërbyesit civil. Ligji për Administratën Tatimore më tutje specifikon obligimet dhe të drejtat e ATK-së për përgjegjësi shtesë ndaj zyrtarëve të saj. Ky Ligj vë theks në inspektorët tatimorë dhe organet mbikëqyrëse të cilat garantojnë integritetin institucional.

Për shkak të pushtetit të madh dhe diskrecionin që kanë inspektorët e ATK-së në raport me bizneset, krijohet rreziku që inspektorët të përfshihen në vepra të korrupsionit me qëllim të përfitimit për vete apo anëtarët e afërm të familjes. Kjo ndodh kryesisht në kuadër të kontrollit, vizitave dhe shqiptimit të gjobave që u bëjnë bizneseve, por në disa raste edhe ofrimin e pëlqimeve apo licencave për operim, si në rastin e lojërave të fatit (bastoret dhe kazinot).

Për të parandaluar këtë gjë, me legjislacion janë krijuar mekanizma mbikëqyrës, të cilët jo vetëm se përcjellin në nivel administrativ rastet e mundshme të korrupsionit për t'i denoncuar ato në institucionet ndjekëse, por edhe angazhohen në masa parandaluese. Sidoqoftë, përveç këtij rreziku që inspektorët të përfshihen në vepra të korrupsionit, ekziston edhe rreziku i dytë, që të njëjtit të jenë shënjestër e ndikimit, dhunës, shtrëngimit apo kërcënimeve për të kryer punën në një apo mënyrën tjetër.

Duke tentuar të balancohet në mes të këtyre dy interesave publike, Ligji për Shërbimin Civil dhe ai për Administratën Tatimore të Kosovës, kanë paraparë jo vetëm institucionet hetuese por edhe ato mbrojtëse. Këto institucione garantojnë se të drejtat e inspektorëve nuk do të shkelen nga menaxhmenti apo palët e treta.

Raporti në anekset te tij përmban përshkrimin e vendimeve të KPMSHC dhe ofron një sqarim mbi mekanizmat e procedurës disiplinore brenda ATK-së duke filluar nga Divizioni i Standardeve Profesionale (DSP) si organ hetimor administrativ, Komisionin Disiplinor si shkallë e parë dhe Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) si shkallë e dytë në procedurën administrative brenda ATK-së.

Qëllimi i raportit

Duke parë besimin e ulët të qytetarëve në ATK dhe perceptimeve rreth nivelit të korrupsionit në këtë institucion, që nga gushti i vitit 2018, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe Demokraci Plus (D+), të mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë kanë bashkuar përvojën, resurset dhe njohuritë për të dhënë kontribut në monitorimin e ATK-së dhe promovimin e rasteve model të luftimit të evazionit fiskal.

Po ashtu, duke pasur parasysh rëndësinë e integritetit të nëpunësve apo zyrtarëve që punojnë në një institucion, në këtë rast të ATK-së, BIRN dhe D+ janë fokusuar po ashtu në monitorimin e integritetit dhe disiplinës së nëpunësve të ATK-së.

Synimi është që përmes këtij monitorimi të identifikohen "vrimat e zeza" në proces dhe të ngritën "flamujt e kuq" mbi nevojën për përmirësime të standardeve, procedurave dhe bazës ligjore me anë të të cilave mundësohet dhe përmirësohet integriteti brenda ATK-së.

Përveç kësaj, monitorimi dhe vet ky raport, synojnë që të promovojnë edhe rastet pozitive, duke qenë se gjatë këtyre gjashtë muajve të monitorimit direkt, ka pasur edhe raste të zhvillimeve pozitive, ku është vënë në pah profesionalizmi dhe reagimi i shpejtë i ATK-së.

Ky raport është një pjesë e punës së realizuar nga muaji shtator 2018 deri në shkurt 2019, pra mbulon një periudhë gjashtë mujore të monitorimit direkt. Ky raport do të jetë i pari në serinë e raporteve që do të dalin si rrjedhojë e monitorimit të drejtpërdrejtë deri në mars të vitit 2021. Kjo seri raportesh ka synim kryesor monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe avokimin për ndryshimet e nevojshme ligjore të identifikuara paraprakisht.

Raporti është ndër të parët të realizuar nga OJQ-të vendore dhe në aneks ka përfshirë edhe informata dhe të dhëna për mekanizmat disiplinor brenda ATK-së dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil si institucion i pavarur nën Kuvendin e Kosovës. Këto katër hallka përbëjnë shkallët nëpër të cilat kalon një procedurë disiplinore nga fillimi deri në fund në një procedurë administrative.

- Divizioni i Standardeve Profesionale
- Komisioni Disiplinor
- Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve e Ankesave
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këtij raporti të monitorimit i ka paraprirë publikimi i një analize për nevojën për ndryshimet ligjore dhe të procedurave standarde të operimit të ATK-së e cila është publikuar në dhjetor 2018.

Metodologjia e monitorimit të ATK-së

Ky raport përmban të dhëna të grumbulluara në periudhën tetor 2018 - shkurt 2019 nga monitorimi direkt i proceseve disiplinore dhe atyre të ankesave brenda ATK-së. Raporti gjithashtu përmban të dhëna nga analizimi i vendimeve disiplinore, ankesave dhe vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të cilat janë nxjerrë gjatë vitit 2018.

Hulumtimi ka për qëllim të monitorojë edhe procedurat e deklarimit të konfliktit të interesit dhe deklarimit të pasurisë brenda ATK-së duke sjellë një analizë për gjendjen aktuale dhe të ofrojë rekomandime konkrete për ndryshime të mundshme.

Duke kryer monitorime direkte, duke testuar procedurat e reagimit dhe analizuar statistikën e nxjerra, raporti ka matur edhe procedurat e raportimit të rasteve në linjat e raportimit të ATK-së të cilat janë të hapura për raportimin e korrupsionit dhe keqpërdorimeve brenda ATK.

Për këtë qëllim, BIRN dhe D+ kanë analizuar po ashtu 17 vendime disiplinore të nxjerra nga komisionet brenda ATK si dhe ka analizuar nëntë (9) vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës. Po ashtu, BIRN dhe D+ kanë monitoruar edhe tre (3) raste direkte që janë trajtuar nga organet disiplinore të ATK-së gjatë periudhës direkte të monitorimit.

Pjesë e monitorimit ka qenë edhe efikasiteti i ATK-së në reagimin ndaj ankesave të qytetarëve. Në tetor të vitit 2018, KALLXO.com ka lansuar fushatë për të inkurajuar qytetarët të raportojnë evazionin fiskal dhe shmangiet tatimore. Në mesin e dhjetëra raportimeve janë përzgjedhur shtatë (7) raportime për t'u testuar nëse ATK reagon me kohë për t'i trajtuar ato.

Për llogari të këtij monitorimi, Divizioni i Standardeve Profesionale është njoftuar me shkresa ligjore nga BIRN. Shkresat kanë përmbajtur informacione për parregullsi dhe evazion fiskal. Bazuar në këto raportime janë testuar procedurat e reagimit të ATK-së në shtatë raportime për shmangie tatimore, evazion fiskal dhe organizim të kundërligjshëm të lojërave të fatit.

Gjetjet Kryesore

Amnistia e shkeljeve

- Monitorimi nga BIRN dhe D+ ka arritur të identifikojë probleme serioze në qasjen se si Administrata Tatimore e Kosovës i është qasur disiplinimit të nëpunësve të saj.
- Me gjithë problemin me evazionin e lartë fiskal në vend e cila i atribuohet edhe mospunës së inspektorëve të ATK-së, menaxhmenti i ATK-së brenda vitit 2018 nuk ka arritur të ndërmarrë vendime disiplinore të cilat do t'i ndëshkonin seriozisht zyrtarët dhe inspektorët të cilët janë të thirrur për të mbledhur tatimet. Analiza e vendimeve disiplinore të vitit 2018 tregon se brenda vitit edhe përkundër disa shkeljeve serioze, asnjë zyrtar i ATK-së nuk është larguar nga puna për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore. Të vetmit të suspenduar janë 10 zyrtarë të cilët janë arrestuar ose ndjekur nga organet e ndjekjes pasi mbi ta janë ngritur dyshime për kryerjen e veprave penale.
- BIRN dhe D+ gjatë monitorimit kanë konstatuar se ATK ka zhvilluar një politikë të tolerimit të shkeljeve të rënda disiplinore të cilat nuk janë ndëshkuar sa duhet. Rastet ku është konstatuar se zyrtari ka fshehur pasurinë, ka pasur konflikt interesi me biznesin privat dhe nuk ka shqiptuar gjobë ndaj biznesit për mungesën e arkës fiskale kanë kaluar me masa disiplinore të transferit por jo edhe me largim nga puna.

Mospërfilljet në deklarin e pasurisë

- Në kontrollin e integritetit, menaxhmenti i ATK-së në dy vitet e fundit nuk ka ndërmarrë hapa për t'i obliguar zyrtarët e ATK-së të deklarojnë apo rideklarojnë pasurinë e tyre. Ligji i ATK-së e ka lënë në diskrecionin e drejtorit të ATK-së që në raste të caktuara të kërkojë nga zyrtarët e ATK-së të deklarojnë pasurinë.
- Një vendim i tillë nuk është marrë në dy vitet e fundit duke krijuar kështu një boshllëk në deklarin e pasurisë. Duke pasur parasysh rëndësinë e deklarinimit të pasurisë nga zyrtarët e ATK-së, një vonesë e tillë është e paarsyeshme. Si rrjedhojë, gjatë këtij viti ka pasur vetëm një procedurë disiplinore ndaj një zyrtari të ATK-së e cila është iniciuar për mosdeklarim të plotë të pasurisë.
- Raporti ka gjetur se ndaj zyrtarit që është iniciuar procedura disiplinore, ATK ka shqiptuar masë disiplinore, ndërsa rasti nuk është ndjekur penalisht me kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit. BIRN dhe D+ kanë gjetur se ATK në procedurat e saj standarde nuk e ka të familjarizuar procedurën që në rastet kur haset deklarim i rremë i pasurisë të bëjë kallëzim penal në prokurori. Neni 437 i Kodit Penal parasheh që *"Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë(5) vjet"*.

Në ligjin 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, aktualisht Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së mund të kërkojë deklarata financiare (Deklaratë të Pasurisë) që është detyruese vetëm për zyrtarin e ATK-së, ndërsa për anëtarë të familjes së zyrtarit nuk obligohet me ligj. DSP ka dërguar në Ministri të Financave propozim-ndryshime që familja të specifikohet me ligj për ATK-në i cili është duke u ndryshuar.

Mungesa e resurseve për të kontrolluar integritetin

- Në kontrollin e integritetit, raporti gjen se ATK vazhdon të mos e ketë prioritet këtë çështje. Divizioni i Standardeve Profesionale (DPS) e cila është e thirrur për të trajtuar këto çështje ka vetëm tre zyrtarë të punësuar dhe këto resurse janë të limituara për të kontrolluar rreth 800 nëpunës të ATK-së. ZSP është e bazuar në drejtorinë qendrore të ATK-së dhe kontakti i tyre me qytetarët dhe raportuesit e mundshëm të sjelljeve të pahijshme të zyrtarëve të ATK-së është i limituar.
- Raporti e identifikon si problematike edhe përbërjen e komisionit disiplinor sepse përbërja e këtij komisioni jo çdo herë ka reflektuar diversitetin gjinor në përbërjen e tij. Po ashtu, as komisioni disiplinor e as ai i ankesave nuk kanë anëtarë të caktuar i cili do t'i zëvendësonte anëtarët në rastet kur paraqitet konflikt potencial i interesit.

Konflikti ATK - KPMSHC

- Në disiplinimin dhe shqiptimin e masave ndaj zyrtarëve të ATK-së, monitorimi gjen probleme serioze në procedurat dhe formën se si ATK i ka proceduar ato.
- Monitorimi gjën se shumë prej vendimeve disiplinore dhe atyre të transfereve janë anuluar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për shkak të shkeljeve procedurale. Ky institucion gjatë vitit 2018 ka marrë shtatë (7) vendime kundër ATK-së.
- Ajo çfarë është më problematike është që shkeljet e identifikuar nga ky Këshill kanë vazhduar të përsëriten nga ATK.

Defektet teknike në procedurë

- Në trajtimin e brendshëm të shkeljeve të pretenduara dhe rasteve disiplinore, monitorimi gjen probleme të organizimit dhe krijimit të rregullave procedurale të mbarëvajtjes së procedurës. Monitorimi gjen se dy komisionet nuk kanë procedurë standarde të publikimit të orareve të takimeve të tyre. Në njërin nga rastet e monitoruara, monitoruesit e BIRN dhe D+ kanë konstatuar se pala nuk është ftuar me kohë, pasi pala ishte ftuar ditën kur është mbajtur seanca. Rregullorja thotë se ftesa duhet t'i dërgohet palëve dy ditë më herët.

- Po ashtu, seancat shpeshherë zhvillohen pa praninë e palëve të cilët njoftohen vetëm me vendimet përfundimtare. Kjo procedurë limiton procesin e të provuarit dhe sqarimit të rrethanave të paraqitura në ankesa.
- Gjatë monitorimit të procedurave në komisionin e ankesave, monitoruesit kanë vërejtur probleme bazike të procedurës. Për shembull, procesverbali i takimit mbahet me dorë dhe në të njëjtin nuk shkruhen pjesa më e madhe e deklarimeve të bëra gjatë procesit.
- Palët në fund të takimit nuk nënshkruajnë procesverbalin, ndërsa nuk ka një procedurë të saktë se si nënshkruhet dhe miratohet procesverbali.
- Në aspektin organizativ, monitoruesit kanë konstatuar se proceset e monitoruara kanë pasur edhe probleme teknike të hapësirave për shkak se takimet janë mbajtur në zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm dhe kjo është vlerësuar si një hapësirë joadekuate për mbajtjen e seanceve të tilla.

Ripërtëritja e gabimeve

- Analiza po ashtu konstaton se ATK pas trajtimit të rasteve disiplinore nuk e ka të ndërtuar mekanizmin e ndërmarrjes së masave edukuese dhe atyre preventive. Në një rast është konstatuar se ankesa ndaj një zyrtari për mosvijimin në punë ishte kryer jashtë afatit gjë që e kishte bërë ankesën të pabazuar, ndërsa ATK nuk është kujdesur që t'i paralajmërojë zyrtarët e tjerë që rastet e tilla t'i deklarojnë me kohë. Mungesa të tilla krijojnë hapësira për ripërtëritjen e gabimeve të kryera në procesin e disiplinimit.

Sinjalizimi i dyshimeve dhe mbrojtja e sinjalizuesve

- ATK ende nuk ka mekanizma të mbrojtjes së sinjalizuesve brenda institucionit dhe te bizneset të cilat i inspektion. Kjo mungesë i atribuohet edhe faktit që Kosova ka miratuar tek në muajin nëntor të vitit 2018 Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Bazuar në ligj është e domosdoshme që ATK të nisë krijimin e mekanizmave mbrojtës për sinjalizuesit.
- Raporti ka analizuar edhe linjat e raportimit për evazion fiskal dhe parregullësi tatimore. Analizat statistikore tregojnë se ATK ka numër të vogël të rasteve të raportuara për shmangie tatimore nga qytetarët. Në linjën e raportimit të rasteve, të dhënat tregojnë se më pak se një raportim ndodh në ditë në vendin ku evazoni fiskal llogaritet me qindra miliona euro. Kjo e dhënë tregon se qytetarët janë duke raportuar fare pak në linjën e ATK-së të krijuar për të raportuar evazionin fiskal.

Testet e efektshmërisë së raportimeve/ankesave

- Në kuadër të monitorimit të punës së ATK-së, BIRN dhe D+ kanë testuar edhe reagimin e ATK-së në ankesat e qytetarëve. Tetë shkresa zyrtare me raporte konkrete janë dërguar në zyrat e ATK-së me qëllim denoncimin e shmangieve tatimore dhe lojërave të kundërligjshme të fatit. Në këto raste inspektorët e ATK-së kanë reaguar dhe konstatuar se raportimet ishin të bazuara.
- Megjithatë, testet tregojnë që koha e reagimit të ATK-së për të trajtuar ankesat dhe raportimet për keqpërdorime është e gjatë. Nga raportimi deri te dalja në terren e inspektorëve është dashur të kalojnë më shumë se 24 orë gjë që shumë herë e bën të pamundur sigurimin e provave në rastet kur qytetarët raportojnë për evazion fiskal. (Shih Tabelën e raportimeve në Anex).

Përmbledhje dhe analizë e vendimeve të Komisionit Disiplinor në ATK

Kjo pjesë përmban gjashtë vendime të cilat janë marrë nga Komisioni Disiplinor brenda periudhës shkurt-nëntor 2018 në ATK. Vendimi i dytë dhe i katërt do të trajtohen bashkë sepse është e njëjta çështje vetëm se Komisioni Disiplinor ka vendosur për herë të dytë pas rikthimit të çështjes në këtë komision nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA). Fillimisht do të jepen përshkrime të shkurtra të situatës sipas secilit vendim dhe masa e shqiptuar për secilin vendim për të kaluar te pjesa e analizës së përgjithshme për të gjitha vendimet. Përveç vendimit 5/2018 për të cilin nuk e kemi vendimin e KZKA-së (shkallës së dytë), asnjë vendim tjetër i trajtuar i vitit 2018 nuk ka kaluar në shkallë të tretë, atë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMSHC).

Vendimi nr. 1/2018 kundrejt zyrtarit të mbledhjes së detyrueshme për vozitje nën ndikim të alkoolit

Rasti sipas vendimit nr. 01/2018³ ka të bëjë me shqiptimin e masave disiplinore ndaj një zyrtari të mbledhjes së detyrueshme të ATK-së ngase nën ndikim të alkoolit kishte shkaktuar aksident trafiku me veturë zyrtare. Zyrtari në fjalë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka qenë duke udhëtuar me veturë zyrtare dhe për shkak të mospërshtatjes së shpejtësisë së vozitjes, kushteve të rrugës dhe vozitjes nën ndikimin e alkoolit, ka pësuar aksident trafiku duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale. Nga raporti i policisë që ka dalë në vendin e ngjarjes është bërë e ditur se sasia e alkoolit ka qenë më e lartë se sa sasia e lejuar me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor⁴.

³ Vendimi Nr. 01/2018 i datës 22/02/2018 i Komisionit Disiplinor në kuadër të ATK-s

⁴ Ligji 05/L 088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, neni 233, paragrafi 2: <https://bit.ly/2N3C7FA>

Duke pasur parasysh këtë fakt, me kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të bazuar në raportin e Divizionit së Standardeve Profesionale (DSP) është iniciuar procedurë disiplinore ndaj inspektorit në fjalë. Zyra e Burimeve Njerëzore në ATK ka përcjellë kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor brenda ATK-së. Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar të gjitha raportet dhe faktet që ka pasur në dispozicion dhe po ashtu ka ftuar inspektorin tatimor në seancë dëgjimore pranë këtij komisioni. Komisioni Disiplinor duke u bazuar në faktet dhe dëshmitë që i ka poseduar ka vërtetuar përgjegjësinë disiplinore të zyrtarit të ATK-së për veprimin në kundërshtim me Rregulloren Nr. 04/2011⁵ për Procedurat Disiplinore dhe Kodin e Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e ATK-së⁶. Me këtë rast komisioni ka shqiptuar masën e rëndë disiplinore: "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një periudhë prej 1 viti".

Vendimi nr. 2/2018 dhe nr. 4/2018 kundrejt tre zyrtarëve të një drejtorie rajonale të ATK-së për shqiptim të gjobës me vlerë zero euro

Rasti sipas vendimit nr. 02/2018⁷ ka të bëjë me shqiptimin e masës disiplinore ndaj tre zyrtarëve të ATK-së të cilët nuk kanë vepruar sipas detyrës zyrtare në respektim të ligjit, pasi nuk kanë shqiptuar gjobë ndaj një biznesi apo gjoba që kanë shqiptuar përmes Zyrës për Gjopa dhe Ndëshkime ka qenë me vlerën zero. Njëri prej zyrtarëve ka qenë Drejtor i drejtorisë rajonale në një rajon të caktuar, tjetri zyrtar ka qenë ndihmës drejtor në të njëjtin rajon dhe zyrtari i tretë ka qenë mbledhës tatimor duke ushtruar edhe detyrën e zyrtarit në ekipin e Zyrës për Gjopa dhe Ndëshkime në rajonin përkatës. Rasti ishte iniciuar nga një inspektor tatimor i këtij rajoni i cili ishte ankuar në Divizionin e Standardeve Profesionale ndaj vendimit për shqiptimin e kësaj gjobe me vlerën zero nga Zyra për Gjopa dhe Ndëshkime ndaj biznesit i cili nuk ishte pajisur më arkën fiskale.

Pas ankesës në fjalë, Divizioni i Standardeve Profesionale në bazë të kompetencave të saj ka filluar ta hetojë rastin dhe ka përpiluar një raport për Drejtorin e Përgjithshëm të ATK-së. Pas raportit në fjalë, Drejtori i Përgjithshëm ka kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore që rasti të shkojë në procedurë disiplinore dhe me këtë rast kalimin e rastit në Komisionin Disiplinor brenda ATK-së. Komisioni Disiplinor pas analizimit të disa raporteve dhe dëshmimeve duke u nisur nga ankesa e inspektorit, raportit të DSP-së dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore, sipas Rregullores për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ka shqiptuar masën e njëjtë disiplinore për të tre zyrtarët në fjalë: "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një (1) vit".

⁵ Rregullore Nr. 04/2011 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6, paragrafi 1.9 : <https://bit.ly/2DkIKzp>

⁶ Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e Administratës Tatimore, neni 11, paragrafi 3 dhe 4 pika 4.2 dhe neni 13, paragrafi 2: <https://bit.ly/2UT9J7m>

⁷ Vendimi Nr. 02/2018 i datës 09/03/2018 i Komisionit Disiplinor në kuadër të ATK-së.

Sipas këshillës juridike të dhënë me vendimin në fjalë, të tre zyrtarët e ATK-së kishin paraqitur ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) brenda ATK-së duke pretenduar se vendimi i Komisionit Disiplinor është jo i drejtë dhe i pabazuar ligjërisht. KZKA në mbledhjen e mbajtur për këtë rast ka marrë vendimin për kthimin në rishqyrtim të rastit edhe njëherë në Komisionin Disiplinor pasi kishte vërtetuar se Komisioni Disiplinor ka bërë vetëm përshkrim të rrethanave në arsyetimin e vendimit mirëpo nuk ka cekur dispozitat ligjore në bazë të të cilave ka bazuar vendimin për shqiptimin e masës disiplinore si më lartë dhe se komisioni në përbërjen e tij nuk ka respektuar barazinë gjinore të kërkuar me ligj. KZKA kishte vendosur njëjtë për të tre personat me një vendim të përbashkët duke e kthyer këtë çështje në rishqyrtim në Komisionin Disiplinor.

Për shkak të kthimit të lëndës edhe njëherë në Komisionin Disiplinor, ky i fundit ka shqyrtuar vendimin e KZKA dhe ka nxjerrë vendimin 04/2018⁸ me anë të të cilit personave në fjalë u ka shqiptuar masën e njëjtë disiplinore vetëm se tani duke u thirrur në dispozita ligjore të cilat sanksionojnë sjellje të tilla të mosrespektimit të detyrës zyrtare nga zyrtarët e ATK-së. Vlen të theksohet se masa disiplinore është bazuar në Ligjin për shërbimin civil, nenet 51 pika 1 dhe 52 pika 1 të cilët i dedikohen ushtrimit të detyrës dhe detyrimin për zbatimin e ligjit dhe detyrimin për mos-shpërdorimin e autoritetit⁹. Masa e përsëritur disiplinore e shqiptuar ndaj tre zyrtarëve të ATK-së ka qenë: "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndali i gradimit për një (1) vit".

Vendimi nr. 3/2018 kundrejt menaxherit të drejtorisë rajonale për mungesën në punë pa paralajmërim

Rasti sipas vendimit nr. 03/2018¹⁰ është iniciuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, në fakt nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale kundër një menaxheri në po të njëjtën drejtori, për shkak të mungesës në punë të këtij të fundit. Rasti nuk ka kaluar në procedurë disiplinore të Komisionit Disiplinor me arsyetimin se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk e ka paraqitur rastin brenda dy ditëve në zyrën e burimeve njerëzore në institucionin përkatës dhe sipas Rregullores për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil¹¹, kërkesa e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë është hedhur poshtë.

Rasti ka ndodhur në kohën e mbajtjes së zgjedhjeve lokale në vitin 2017 kur menaxheri i një njësie rajonale për shkak të kandidimit të tij për kryetar komune, ka kërkuar pushim pa pagesë në afatin prej një (1) muaji në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Pushimi pa pagesë ka qenë i lejuar për zyrtarin në fjalë deri në certifikimin final të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) edhe pse certifikimi i tyre kishte ndodhur tek pas përfundimit të raundit të dytë të zgjedhjeve si rezultat i organizimit të balotazhit në atë komunë.

⁸ Rregullore Nr. 04/2011 për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6, paragrafi 1.9 : <https://bit.ly/2DkIKzp>

⁹ Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e Administratës Tatimore, neni 11, paragrafi 3 dhe 4 pika 4.2 dhe neni 13, paragrafi 2: <https://bit.ly/2UT9jTm>

¹⁰ Vendimi Nr. 02/2018 i datës 09/03/2018 i Komisionit Disiplinor në kuadër të ATK-së.

¹¹ Rregullore nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, Neni 12, paragrafi 1.

Megjithatë, edhe pas certifikimit të rezultateve nga KQZ më 11 dhjetor 2017, zyrtari në fjalë nuk ishte paraqitur në punë deri më datën 03 janar 2018. Sipas interpretimit ligjor të zyrës ligjore në drejtorinë përkatëse, çdo kandidat i emëruar për zgjedhje komunale duhet të lajmërohet në punë më se largu një (1) javë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve komunale. Mungesa në punë e zyrtarit në fjalë është vlerësuar të jetë 13 ditë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore nuk ka pasur ndonjë kërkesë tjetër për vazhdim të pushimit apo informim për mungesën në vijim.

Duke pasur këtë situatë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka kërkuar nga zyra e burimeve njerëzore që rasti të përcillet në Komisionin Disiplinor dhe kërkesa për këtë ishte bërë më 08 mars 2018 në këtë zyrë derisa Komisioni Disiplinor kishte pranuar kërkesën nga zyra në fjalë më 09 mars 2018. Rasti apo kërkesa për inicim të procedurës kishte të bënte me faktin që zyrtari i cili kishte qenë kandidat për kryetar komune nuk ishte lajmëruar në punë në afatin e paraparë dhe në fakt mos informimit të pushimit prej 13 ditë pune. Komisioni Disiplinor është mbledhur sipas kërkesës dhe ka shqyrtuar një numër të dëshmime lidhur me këtë rast mirëpo kishte hedhur poshtë kërkesën e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë me arsyetimin se kërkesa ishte bërë jashtë afatit ligjor. Sipas Komisionit Disiplinor i cili është thirrur në Rregulloren për Procedurë Disiplinore në Shërbimin Civil, rasti është dashur të paraqitet nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë brenda dy (2) ditë pune në burime njerëzore dhe pastaj zyra përkatëse ta përcjellë atë në Komisionin Disiplinor. Për këtë shkak, rasti apo kërkesa është hedhur poshtë dhe Komisioni Disiplinor nuk ka vazhduar me procedurën.

Vendimi Nr. 5/2018 kundrejt inspektorit për sjellje të keqe ndaj zyrtarëve tjerë të ATK-së

Rasti sipas vendimit nr. 05/2018¹² ka të bëjë me sjellje të keqe të një zyrtari të ATK-së ndaj disa zyrtarëve tjerë të të njëjtit institucion të cilat kanë ndodhur përmes dërgimit të mesazheve me telefon dhe emailave të cilët kanë pasur përmbajtje fyese për zyrtarët në fjalë. Këta të fundit e kanë ngritur këtë shqetësim tek udhëheqësi i tyre i drejtpërdrejtë i cili ka parashtruar shqetësim te Drejtori i Drejtorisë Rajonale përkatëse për sjelljet ndaj kolegëve të ATK-së. Pastaj, Drejtori i Drejtorisë Rajonale kishte kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së marrjen e masave ndaj zyrtarit në fjalë.

Si rezultat i kësaj, me kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm, Zyra për Burime Njerëzore (ZBNj) në kuadër të ATK-së me të gjitha provat dhe shënimet që ka pasur për rastin në fjalë, ka dërguar rastin në Komisionin Disiplinor brenda ATK-së. Sipas përfundimeve të Komisionit Disiplinor, vërejtje me gojë i ishte shqiptuar më herët zyrtarit në fjalë dhe po e njëjta sjellje kishte vazhduar nga po i njëjti zyrtar. Komisioni Disiplinor në bazë të mandatit dhe detyrave që ka në bazë të legjislacionit përkatës, kishte analizuar të gjitha dëshmitë e pranuar nga ZBNJ dhe kishte ftuar zyrtarin në fjalë në seancë dëgjimore lidhur me këtë rast¹³.

¹² Vendimi Nr. 01/2018 i datës 07/06/2018 i Komisionit Disiplinor në kuadër të ATK-së.

¹³ Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, Neni 71: <https://bit.ly/2FSB4në>

Komisioni Disiplinor, pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe dëgjimit paraprak të palës, ka konstatuar se zyrtari i ATK-së ka kryer shkelje të rëndë disiplinore pasi ka ushtruar presion përmes mesazheve me përmbajtje fyese si dhe shqetësim për jetën private të punëtorëve të tjerë. Sipas këtij konstatimi, Komisioni Disiplinor duke u mbështetur në Rregulloren për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil, ka shqiptuar masën disiplinore: "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një periudhë prej (tre) 3 vite".

Vendimi nr. 6/2018 kundrejt inspektorit për keqpërdorim të detyrës zyrtare

Rasti sipas vendimit nr. 06/2018 ka të bëjë me iniciimin e procedurës disiplinore nga një Drejtor rajonal për dyshimet e konfliktit të interesit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare të një inspektori.

Rasti në fjalë ka të bëjë me pretendimet e Drejtorit rajonal se inspektori ndaj të cilit është zhvilluar kjo procedurë disiplinore gjatë kohës sa ka qenë inspektor ka qenë i angazhuar edhe në një biznes privat i cili nuk ka deklaruar obligimet tatimore. Drejtori Rajonal kishte kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore që rasti të kalojë në procedurë disiplinore për t'u zhvilluar nga Komisioni Disiplinor. Komisioni Disiplinor ka zhvilluar hetimin administrativ me ç'rast kishte kërkuar sqarimin nga Divizioni i Standardeve Profesionale lidhur me angazhimet e inspektorit në biznesin privat dhe se a kishte ekzistuar konflikti i interesit në atë rast. Komisioni Disiplinor gjatë shqyrtimit të shkeljes së supozuar dhe pas pranimit të përgjigjeve nga ana e DSP, konstatoi se inspektori ndaj të cilit është zhvilluar procedura disiplinore nuk është përgjegjës për shkeljen e pretenduar dhe se lirohet nga përgjegjësia disiplinore. Njëkohësisht Komisioni udhëzoi iniciuesin e rastit se nëse siguron prova për keqpërdorim të pozitës, t'i drejtohet organeve ndjekëse sepse keqpërdorimi është vepër penale e cila parashihet me Kodin Penal.

Vendimi nr. 7/2018 kundrejt inspektorit për konflikt interesi dhe mos-shqiptim të gjobës për mungesë të arkës fiskale

Rasti sipas vendimit nr. 07/2018¹⁴ ka të bëjë me konstatimin e shkeljes së rëndë disiplinore nga një inspektor i ATK-së në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) dhe rrjedhimisht shqiptimin e masës disiplinore nga Komisioni Disiplinor. Rasti në fjalë ka të bëjë me sjelljet kundërligjore të inspektorit tatimor, duke dështuar t'i përmbahet detyrave dhe përgjegjësisë së tij si inspektor në ATK. Këto sjellje kundërligjore janë shfaqur kur inspektori tatimor: 1) sipas sqarimit të Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK) ka hyrë në konflikt interesi duke qenë person i autorizuar në një biznes privat; 2) në deklaratën e konfliktit të interesit të dorëzuar në Divizionin e Standardeve Profesionale (DSP), inspektori tatimor nuk ka deklaruar që vajza e tij mban kontabilitetin e regjistrimeve në biznes privat dhe 3) mos-shqiptimin e gjobës për biznesin që nuk ka pasur arkë fiskale.

¹⁴ Vendimi Nr. 07/2018 i datës 28/12/2018 i Komisionit Disiplinor në kuadër të ATK-së.

Rasti është nisur sipas një denoncimi anonim mbi këtë situatë dhe pas një raporti me gjetje dhe konstatime të ZSP-së, Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së kishte kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore që rasti të kalojë në procedurë disiplinore për t'u zhvilluar nga Komisioni Disiplinor. Ky i fundit ka zhvilluar hetimin administrativ me ç'rast kishte kërkuar sqarimin për konflikt të interesit nga AKK, kishte vërtetuar pohimet në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) nëse inspektori kishte qenë i autorizuar në biznes privat dhe kishte mbledhur prova të tjera lidhur me këtë situatë.

Nga këto gjetje, Komisioni Disiplinor ka vërtetuar përgjegjësinë disiplinore të inspektorit tatimor për veprim në kundërshtim me legjislacionin në shërbimin civil dhe Kodin e Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e ATK-së¹⁵ dhe ka vendosur masën disiplinore: "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme, dhe ndalim gradimi për 3 vite".

Analiza e vendimeve

Ajo çfarë është e përbashkëta e të gjitha¹⁶ vendimeve është masa e njëjtë disiplinore e shqiptuar për të gjithë personat e përfshirë me një dallim në vite sa i përket ndalesës për gradim. Vitet e ndalimit në gradim për personat e përfshirë janë një (1) vit në dy raste dhe 3 (vite) në dy raste tjera¹⁷. Sipas Rregullores për Procedurën Disiplinore në Shërbimin Civil në bazë të së cilës janë shqiptuar këto masa, ndalimi i gradimit për këtë masë shkon deri në pesë (5) vite dhe shqiptohet nga Komisioni Disiplinor. Në të gjitha këto raste ka qenë Komisioni Disiplinor i cili ka shqiptuar këtë masë dhe është thirrur në Ligjin për shërbimin civil dhe legjislacionin tjetër relevant i cili i jep këtë kompetencë dhe përgjegjësi komisionit përkatës.

Megjithatë, nëse analizohen temat apo objekti i rasteve, mund të themi se në disa raste ka mundur të shqiptohet masë tjetër disiplinore në vend të largimit nga zyra dhe transferimit në një lokacion tjetër. Masa disiplinore e largimit nga zyra dhe transferimit në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme duket të jetë masa e preferuar për shkak të shkëputjes së lidhjeve në mes të inspektorëve dhe bizneseve në atë rajon pas largimit nga zyra dhe transferimit në një lokacion tjetër. Mirëpo, në vendimin nr. 1/2018 sipas të cilit zyrtari i mbledhjes së detyrueshme kishte shkaktuar aksident trafiku duke vozitur nën ndikimin e alkoolit dhe shkaktuar dëmtim të veturës zyrtare, ndaj tij ka mundur të shqiptohet një masë tjetër e rëndë disiplinore në vend të masës së largimit nga zyra, transferimit në një lokacion tjetër dhe ndalim i gradimit për një periudhë prej një (1) viti. Shkelja e shkaktuar, edhe pse në kategorinë e shkeljeve të rënda, dhe masa e shqiptuar po ashtu në kategorinë e masave për shkelje të rënda dhe serioze, vërehet se nuk ka një lidhje logjike në mes të shkeljes dhe masës së shqiptuar, pra masa nuk ka qenë adekuate. Meqenëse zyrtari i

¹⁵ Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e ATK-së, neni 9, pika 3.2: <https://bit.ly/2UT9jTm>

¹⁶ Vendimi 3/2018 nuk ka masë të shqiptuar pasi Komisioni Disiplinor kishte vlerësuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kishtë bërë kërkesë me vonës për hapjen e procedurës disiplinore dhe si rrjedhijë kërkesa ishte hudhur poshtë.

¹⁷ Vendimet 2/2018 dhe 4/2018 kanë të njëjtën masë disiplinore pavarësisht që Komisioni Disiplinor ka vendosur dy herë mbi të njëjtën çështje pas kthimit në rishqyrtim nga KZKA.

mbledhjes së detyrueshme ka shkaktuar aksident trafiku nën ndikim të alkoolit dhe ka dëmtuar veturën zyrtare, masë tjetër si për shembull "pezullimi i ushtrimit të detyrave dhe ndalimi i 1/3 së rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj" ka mundur të shqiptohet nga komisioni disiplinor. Meqenëse është dëmtuar prona e institucionit (vetura) nga aksidenti nën ndikimin e alkoolit, masë më e logjikshme duket ndalimi i 1/3 të pagës për dy muaj se sa masa e largimit nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër.

Një elaborim i ngjashëm mund të bëhet edhe në rastin e vendimit nr. 5/2018. Në këtë rast, për shkak të sjelljes së keqe të një inspektori të ATK-së ndaj zyrtarëve tjerë të cilët nuk kanë qenë të gjithë me lokacion të njëjtë me inspektorin në fjalë, inspektorit i është shqiptuar masa e largimit nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim gradimi për një periudhë prej tre (3) viteve. Edhe në këtë rast nuk duket të ketë një lidhje logjike në mes të shkeljes dhe masës disiplinore sepse problemi vetëm ka mundur të bartet nga një lokacion në tjetrin. Masë tjetër të cilën ka mundur ta shqiptojë komisioni është edhe masa e pezullimit me pagesë deri në tre (3) muaj apo ndonjë masë tjetër sidomos pasi rasti në fjalë nuk ka pasur të bëjë me lidhjen sipas lokacionit në mes të inspektorit dhe ndonjë biznesi dhe që arsyeja e shqiptimit të kësaj mase ka qenë shkëputja e lidhjes në mes të inspektorit dhe bizneseve apo subjekteve inspektuese të tij.

Në anën tjetër, aplikimi i kësaj mase edhe në rastin kur inspektori është gjetur në konflikt interesi me biznes privat, deklarim të rrejshëm të konfliktit të interesit dhe mosshqiptim të gjobës ndaj biznesit për mungesën e arkës fiskale, duket të mos jetë adekuate me shkeljen e tillë. Në këtë rast kemi shkelje të trefishtë dhe masa që shqiptohet është largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër. Kjo masë mundet të shkëpusë lidhjen në mes të inspektorit dhe biznesit në atë rajon për shkak të ndërrimit të lokacionit për inspektorin, por nuk duket të jetë një masë adekuate dhe konform shkeljeve të rënda disiplinore që ka bërë inspektori në këtë rast.

Në bazë të vendimeve të përshkruara më lartë, masat disiplinore janë shqiptuar ndaj personave të cilët kanë mbajtur këto pozita: zyrtar i mbledhjes së detyrueshme (vendimi nr. 1/2018), drejtor i drejtorisë rajonale, ndihmës drejtor dhe zyrtar në Zyrën për Gjoba dhe Ndëshkime (vendimi nr. 2/2018 dhe nr. 4/2018), menaxher i drejtorisë rajonale (vendimi 3/2018) dhe dy inspektorëve të ATK-së në raste të ndara (vendimet nr. 5/2018 dhe nr. 7/2018). Sa i përket vendeve se ku kanë ndodhur këtë raste, vlen të përmendet se dy janë në Drejtorinë Rajonale në Prizren, dy në Drejtorinë Rajonale në Prishtinë dhe një në Drejtorinë Rajonale në Gjakovë. Sa i përket shkallshmërisë së vendimeve, dy prej vendimeve kanë kaluar edhe në KZKA; njëri prej tyre është kthyer në rishqyrtim te Komisioni Disiplinor dhe në rastin tjetër procedura ka vazhduar deri në KPMSHC si shkallë e tretë.

Rasti sipas vendimit 3/2018 ku kërkesa e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë ishte hedhur poshtë nga Komisioni Disiplinor për shkak se kërkesa ishte bërë jashtë afatit ligjor meriton po ashtu vëmendje dhe elaborim. Për rastin në fjalë, shkelja kishte ndodhur në dhjetor 2017 derisa mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kishte dërguar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore në këtë rast më 8 mars 2018 dhe që Komisioni Disiplinor e kishte hedhur poshtë kërkesën për

shkak se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk kishte bërë kërkesën në burimet njerëzore në afat prej dy (2) ditëve nga koha kur ka ndodhur shkelja. Shkelja që është bërë ka qenë mungesa në punë pa paralajmërim në afat prej 13 ditësh. Në këtë rast, ajo çfarë mund të thuhet menjëherë është afati tepër i shkurtër brenda të cilit mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë mund të paraqesë kërkesën për procedurë disiplinore. Pastaj, dilema që mund të lindë këtu është: çka nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është njoftuar me vonesë për këtë shkelje, pra nuk ka qenë në dijeni për shkeljen dhe vetëm fakti i kalimit të kohës prej dy ditëve e pamundëson atë të nisë një procedurë disiplinore edhe nëse shkelja ka qenë e rëndë? Apo, çka nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me dashje nuk ka paraqitur kërkesë në afatin prej dy ditëve me qëllim që të kalojë kjo kohë dhe të bëhet e pamundur paraqitja e kërkesës për shkelje disiplinore?

Tabela 1: Përmbledhje e disa elementeve të vendimeve trajtuar më sipër

Elementet	Vendimi 1/2018	Vendimi 2/2018 dhe 4/2018	Vendimi 3/2018	Vendimi 5/2018	Vendimi 6/2018
Personi subjekt i vendimit	Zyrtari i mbledhjes së detyrueshme	Drejtori i Drejtorisë Rajonale, ndihmës drejtori dhe një zyrtar	Menaxheri i Drejtorisë Rajonale	Inspektor	Inspektor
Rajoni	Prizren	Gjakovë	Prizren	Prishtinë	Prishtinë
Kush e inicioi rastin?	Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së bazuar në raportin e ZSP-së	Sipas ankesës së inspektorit tatimor	Drejtori i Drejtorisë Rajonale	Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë	Denoncim anonim
Arsyeja	Shkaktim i aksidentit në trafik si pasojë e vozitjes nën ndikimin e alkoolit	Shqiptim i gjobës me zero euro për shkak që biznesi nuk ka pasur arkën fiskale	Mungesa në punë pa lajmërim të Zyrës së Burimeve Njerëzore	Sjellje të keqe ndaj zyrtarëve tjerë të ATK-së por edhe ndaj tatimpaguesve	Konflikt interesi, mos shqiptim i gjobës për mungesë të arkës fiskale
Masa e shqiptuar	Largim nga zyra, transfer në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një (1) vit	Largim nga zyra, transfer në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një (1) vit	Nuk është shqiptuar masë disiplinore	Largim nga zyra, transfer në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për tre (3) vite	Largim nga zyra, transfer në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për tre (3) vite

Përmbledhje dhe analizë e vendimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA)

Gjatë monitorimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, hulumtuesit e BIRN dhe D+ kanë marrë pjesë në tri seanca dëgjimore dhe kanë analizuar edhe 9 vendime të tjera të këtij komisioni.

Rasti i parë i monitoruar ka të bëjë me ankesën e zyrtarit të ATK-së, që të kthehet në vendin e punës sipas akt emërimit pasi kishte qenë i transferuar. Pasi Drejtori i Përgjithshëm nuk e kishte kthyer në vendin e punës sipas akt emërimit, inspektori me anë të anekses ka kërkuar nga KZAK, që ta kthejë në atë pozitë. Duke vendosur sipas ankesës së inspektorit, KZAK, e aprovoi ankesën e inspektorit duke i dhënë të drejtë.

Rasti i dytë i cili është monitoruar ka të bëjë me ankesën e një inspektori të lojërave të fatit. Inspektori në fjalë është i ndëshkuar me masën disiplinore "Largim nga zyra dhe ndalim gradimi për 2 vite", mirëpo edhe përkundër masës, ai ka kërkuar që të kthehet në vendin e punës. Duke vendosur sipas ankesës së tij, KZAK, e ka refuzuar kërkesën për ta kthyer në vendin e punës sipas akt emërimit me arsyetimin se masa disiplinore është në fuqi.

Rasti i tretë i monitoruar ka të bëjë me ankesën e një inspektori ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor. Me vendim të Komisionit Disiplinor, inspektorit në fjalë i është shqiptuar masa e transferimit nga zyra dhe ndalim gradimi në kohëzgjatje prej 3 viteve. Me këtë masë nuk ishte pranuar inspektori dhe brenda afatit ligjor kishte paraqitur ankesën me të cilën ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Komisionit Disiplinor, dhe prishjen e atij vendimi. Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave duke vendosur në lidhje me ankesën e ushtruar nga inspektori vendosi që çështjen t'ia kthejë për rishqyrtim Komisionit Disiplinor.

Analizë e vendimeve

Gjatë monitorimit të rasteve në komisionin e ankesave, monitoruesit kanë vërejtur probleme të cilat i atribuohen moskoordinimit dhe mospërcaktimit strikt të procedurave.

Mbajtja e procesverbalit është njëra nga problemet e para të cilat është vërejtur në këtë proces kur kihet parasysh që gjatë monitorimit janë evidentuar konstatime ku njëri nga anëtarët e komisionit ka nënvizuar se e njeh personin ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore dhe se ai është njeri i mirë. Në mungesë të një standardi të mbajtjes së procesverbalit këto të dhëna nuk mund të argumentohen. Monitoruesit po ashtu kanë gjetur se gjatë seancës dëgjimore procesverbali është mbajtur në fletore gjë që e pamundëson shënimin e rrjedhës së procedurës në mënyrë të plotë dhe konstatimin e deklaratave nga seanca dëgjimore.

Procesverbali duhet të mbahet në formë të shkruar dhe të pastër në të cilën duhet të konstatohen deklaratat kryesore dhe ngjarjet kryesore të seancës, duhet të kopjohet dhe të nënshkruhet pala. Këto nuk ndodhën pasi me përfundimin të seancës dëgjimore pala ankuese doli nga salla dhe as nuk u nënshkrua në procesverbal dhe as nuk e mori një kopje të tillë e cila do të ishte e rëndësishme për përgatitjen e ankesës në shkallën e tretë të KPMSHC.

Komisioni ka probleme edhe me përcaktimin e orarit të seancave ku në njërin nga rastet e monitoruara është konstatuar se pala është thirrur aty për aty edhe përkundër standardit që pala duhet të thirret dy ditë më herët. Në Komentet e raportit, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka arsyetuar se vonesa ka ndodhur për shkak se informimi i palës nuk është bërë me kohë nga Zyra e Personelit. Po ashtu, gjatë analizimit të 11 vendimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave kemi parë që në dhjetë raste, KZKA ka marrë vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e zyrtarëve subjekt i komisionit si të pabazuar. Pra, KZKA pothuajse në të gjitha rastet e ka konfirmuar vendimin e nxjerrë nga Komisioni Disiplinor.

Përmbledhje dhe analizë e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMSHC)

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMSHC) shërben si shkallë e ankesave ndaj vendimeve të shqiptuara nga komisionet e ATK-së. Analiza e vendimeve të KPMSHC-së tregon se në shumicën e rasteve ky institucion ka vendosur në favor të punonjësve të ATK-së duke prishur vendimet e marra nga Komisioni Disiplinor dhe KZKA.

Në shtatë (7) nga nëntë (9) rastet e trajtuara, KPMSHC ka miratuar ankesat e punonjësve duke vendosur që të njëjtit të kthehen në vendin e tyre të punës apo duke e kthyer procesin në rivlerësim. Ndër defektet kryesore që KPMSHC ka konstatuar është mos konstatimi i drejtë i gjendjes faktike gjatë trajtimit të rasteve. Vendimet në këto raste kanë rezultuar me shfuqizimin e masave disiplinore të Drejtorëve të Tatim Paguesve të mëdhenj ndaj udhëheqësve të Ekipeve të kontrollit.

Në tre rastet të cilat KPMSHC i ka kthyer në rishqyrtim ka kërkuar nga KZKA që të shikojë se a ishin vendosur masat brenda afatit ligjor dhe se a kishin bazë ligjore, ku pas rishikimit nga ana e KZKA, ka rezultuar se masat ishin shqiptuar jashtë afatit ligjor dhe se nuk kishin bazë ligjore. Ky konstatim është një dëshmi se shkalla e dytë brenda ATK-së nuk e ka analizuar situatën ashtu siç e ka analizuar KPMSHC.

Kjo e tregon faktin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave vetëm e ka vërtetuar vendimet e drejtoreve, duke ua falur besimin vendimeve të tyre dhe duke i hedhur të tri ankesat poshtë.

Analiza e vendimeve

Në tri raste, KPMSHC e ka aprovuar ankesën e palëve ankuese dhe në dy nga këto raste, KPMSHC e ka aprovuar ankesën e palës ankuese duke e kthyer në vendin e punës sipas akt emërimit.

Në njërin rast, një zyrtar i cili si pasojë e masës disiplinore ishte larguar nga zyra për periudhën prej një viti, pasi kishte kaluar kjo periudhë kishte kërkuar kthimin në vendin e punës sipas akt emërimit, në këtë rast KPMSHC vendosi që ta aprovojë ankesën e tij dhe ta kthejë në të njëjtin vend të punës në të cilin kishte qenë para se t'i shqiptohej masa.

Rasti tjetër ka të bëjë me zyrtarin të cilit me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm i ishte ndërruar pozita e punës dhe duke vendosur sipas ankesës së tij, KPMSHC vendosi ta kthejë në vendin e njëjtë të punës në të cilin kishte qenë më herët.

Nëse e analizojmë rastin e parë, shohim se inspektori ndaj të cilit ishte shqiptuar masa disiplinore, është kthyer përsëri në të njëjtin vend të punës para se t'i shqiptohej masa e tillë disiplinore. Në këtë mënyrë, KPMSHC me vendimet të cilat po i merr po i kthen në të njëjtin vend të punës nga i cili ishin larguar si pasojë e shkeljeve të rënda të cilat i kishin bërë zyrtarët tatimorë.

Duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga zyrtarët e ATK-së, kundër vendimit të KZKA-së, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka marrë aktvendim për ta refuzuar ankesën dhe vërtetuar vendimin e KZKA-së.

Raste të suksesshme

Në dy nga vendimet e marra, KPMSHC ka vërtetuar vendimet e KZKA-së duke i hedhur kështu poshtë ankesat e zyrtarëve të ATK-së.

Njëri rast ka pasur të bëjë me zyrtaren e cila i kishte shqetësuar me mesazhe fyese dhe thirrje në orët e vona të natës kolegët e saj. Nëpërmjet ankesës, ankuesja e kishte kundërshtuar masën në fjalë, mirëpo KPMSHC vendosi që ta refuzojë ankesën e saj.

Në rastin tjetër, KPMSHC e refuzoi ankesën e zyrtarit të ATK-së i cili kishte kërkuar që të kthehet në vendin e punës, mirëpo për shkak se masa disiplinore ishte akoma në fuqi, ankesa e zyrtarit ishte hedhur poshtë.

Përfundime dhe rekomandime

Monitorimi dhe analiza e BIRN dhe D+ arrijnë në përfundimet që ATK duhet të angazhohet seriozisht në përmirësimin e gjendjes dhe treguesve të kontrollit disiplinor. Në Ligjin për deklarimin e pasurisë për zyrtarët e lartë publikë, inspektorët tatimorë duhet të jenë të përfshirë në mesin e zyrtarëve që deklarojnë pasurinë. Gjatë kësaj kohe, ATK dhe institucionet e tjera duhet të punojnë në përmirësimin e bazës ligjore e cila është evidentuar në raportin paraprak.

Për të përmirësuar gjendjen momentale, BIRN dhe D+ rekomandojnë të ndërmerren këto masa të menjëhershme:

- Drejtori i Përgjithshëm të nxjerrë vendim me të cilin obligohen zyrtarët ta rideklojnë pasurinë;
- Ligji i ri për ATK-në dhe Procedurat duhet të përfshijë çështjen e deklarimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit për inspektorët e ATK-së;
- ATK ta organizojë shorteun publik për verifikimin e pasurisë së zyrtarëve të saj;
- ATK t'i edukojë qytetarët për t'i raportuar zyrtarët të cilët bien ndesh me ligjin;
- Divizioni i Standardeve Profesionale duhet të shtohet në staf dhe resurse tjera;
- ATK duhet ta promovojë linjën e raportimit pa pagesë, e cila duhet të jetë e qasshme 24 orë;
- Komisioni Disiplinor duhet të ndërmarrë masa në adresimin e vërejtjeve të KPMSHC;
- ATK duhet ta ashpërsojë politikën ndëshkimore ndaj shkelësve të disiplinës;
- Komisionet e ATK-së duhet të nisin me regjistrimin e procesverbaleve sipas standardeve të kërkuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Oraret e seancave disiplinore dhe të ankesave duhet të jenë publike dhe të thirrura me kohë;
- Komisionet disiplinore duhet të kenë hapësira të përshtatshme për punë;
- Komisioni Disiplinor duhet çdo herë të ketë parasysh diversitetin gjinor në përbërjen e tij në mënyrë që mos të eliminohet mundësia e kthimit të vendimit të tij në rishqyrtim për këtë arsye;

- Komisioni Disiplinor duhet t'i referohet saktë dispozitave ligjore relevante në bazë të të cilave e shqipton një masë disiplinore;
- Komisioni Disiplinor duhet të shqyrtojë shqiptimin e masave tjera të rënda disiplinore dhe jo në çdo vendim të shkojë me masën e njëjtë disiplinore. Shkelja dhe masa disiplinore duhet të jenë në proporcion me njëra- tjetrën sepse masa disiplinore "largim nga zyra dhe transferim..." nuk arrin efektin e dëshiruar në secilin rast;
- ATK së bashku me Ministrinë e Administratës Publike duhet të ndryshojnë afatin prej dy (2) ditëve si afat për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë që të paraqesë një shkelje në Divizionin e Burimeve Njerëzore. Afati duhet të jetë dukshëm më i gjatë dhe i atillë që i lejon kohë të mjaftueshme mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të iniciojë një rast disiplinor;

Shtojca 1: Strukturat nëpër të cilat kalon një procedurë disiplinore brenda dhe jashtë ATK-së

Divizioni i Standardeve Profesionale

Në bazë të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Divizioni i Standardeve Profesionale (DSP) është njësi në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), roli kryesor i së cilës është: të hetojë të gjitha pohimet nga qytetarët për sjellje të keqe të të punësuarve në ATK, të gjitha përpjekjet për të korruptuar zyrtarët tatimorë dhe të gjitha shkeljet e Kodit të Mirësjelljes në ATK.

Po ashtu, DSP heton edhe veprimtari tjera të të punësuarve apo qytetarëve që kërcënojnë sigurinë apo integritetin e ATK-së apo të punësuarve të saj.

DSP ka autorizim të ketë qasje në të gjitha të dhënat e zyrtarëve tatimorë, që t'i intervistojë dëshmitarët të cilët mund të kenë informata që do të ndihmojnë në hetime, të kërkojë dëshmi si dhe informata tjera dhe të ndihmojë në një hetim të autorizuar duke përfshirë nxjerrjen e regjistrimeve bankare.

Po ashtu, DSP përcakton nëse çështja nën hetime duhet të vihet në procedurë administrative apo në procedurë penale, mund të kryejë hetime nën mbikëqyrjen e Prokurorit Publik dhe të kryejë hetime të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe agjencitë të tjera që zbatojnë ligjin në çështjet që lidhen me sigurinë e brendshme, akuzimet për sjellje të keqe të të punësuarve dhe veprimtari tjera të të punësuarve dhe qytetarëve që mund të rrezikojnë integritetin apo sigurinë e ATK-së.

Ankesa për sjellje jo të mirë të ndonjë zyrtari të ATK-së, së pari shkon tek udhëheqësi i drejtpërdrejtë i atij zyrtari, pastaj, është në dorën e udhëheqësit të tij/saj nëse dëshiron ta dërgojë rastin në DSP apo direkt në Komision Disiplinor. Kjo mundësi e zgjedhjes varet nga fakti se sa ka mundësi udhëheqësi të administrojë vet me provat të cilat do të konsiderohen të mjaftueshme për marrjen e vendimit nga ana e Komisionit Disiplinor. Nëse udhëheqësi nuk ka prova apo ato që i posedon nuk janë të mjaftueshme, atëherë rasti përcillet në DSP për hetime dhe prova të mëtejshme.

DSP, për hetimin të cilin e kryen duhet ta përgatisë një raport të cilit ia bashkëngjet edhe dëshmitë tjera dhe së bashku me to atë raport e dorëzon në Komisionin Disiplinor për procedim të mëtutjeshëm.

Komisioni Disiplinor

Komisioni Disiplinor është një strukturë tjetër në kuadër të ATK-së dhe themelohet nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së.

Funksioni i Komisionit Disiplinor në ATK është që t'i dëgjojë palët në lidhje me shkeljen e pohuar, të përcaktojë në bazë të dëshmimeve nëse shkelja është bërë, dhe të marrë vendim mbi masat disiplinore për nëpunësit e ATK-së kur ekziston një dyshim i bazuar se është kryer ndonjë shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor ka përgjegjësi që ta bëjë vlerësimin e sjelljes gjatë kohës së kryerjes së detyrave të tyre të punës, për menaxherët kryesor dhe të gjithë punonjësvë. Neglizhenca, apo dështimi i kryerjes së punëve dhe abuzimi me administratën, paraqesin sjellje jo të mira gjatë ushtrimit të punës brenda institucionit. Komisioni Disiplinor ka për detyrë të dëgjojë provat lidhur me shkeljet e supozuara, të vendosë në bazë të provave nëse është kryer shkelja si dhe të përcaktojë masën disiplinore që duhet shqiptuar.

Në rastet e shkeljeve disiplinore janë paraparë që të shqiptohen edhe masat konform shkeljeve. Për shkelje të lehta mund të shqiptohen këto masa disiplinore si: vërejtja gojore dhe vërejtja me shkrim. Ndërsa, për shkelja të rënda mund të shqiptohen këto masa si: pezullimi nga puna dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor, apo edhe ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Raporti i Komisionit Disiplinor me DSP qëndron në atë se çdo hetim që bëhet nga DSP qoftë për sjellje të keqe të të punësuarve, përpjekjeve për të korrutuar zyrtarët tatimorë apo veprimtari tjera të cilat mund të rrezikojnë integritetin e ATK-së, DSP do t'i raportojë çdo fakt dhe rrethanë të Komisionit Disiplinor i ATK-së. Në vijim të procedurës së brendshme administrative, rruga përtej Komisionit Disiplinor vazhdon te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave po ashtu i themeluar brenda ATK-së. Në qoftë se Komisioni Disiplinor i ka shqiptuar zyrtarit apo nëpunësit masën disiplinore më të lehtë si vërejtje me gojë apo me shkrim, nuk paraqet masë për largimin nga puna të zyrtarit. Mirëpo, në rast se zyrtari apo nëpunësi përsërit sjelljet jo të mira, si neglizhencë apo dështim të kryerjes së detyrave dhe abuzim me administratën, paraqet shkelje të rëndë dhe mbetet në diskrecionin e Komisionit Disiplinor të shqiptojë masën disiplinore, mes të cilave pezullimin apo edhe largimin nga zyra.

Në qoftë se zyrtari apo nëpunësi nuk pajtohet me masat disiplinore që i janë shqiptuar, atëherë ai/ajo mund të paraqesë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në afat prej 30 ditësh. Pastaj, nëse zyrtari nuk pajtohet me vendimin e marrë nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, brenda afatit prej 30 ditësh mund të paraqesë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHC). KPMSHC është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili në mes tjerash i zgjidh ankesat e nëpunësve civilë si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave

Brenda ATK-së ekziston po ashtu Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili themelohet nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së. Komisioni në fjalë ka për detyrë që të shqyrtojë të gjitha ankesat nga të punësuarit në ATK të cilët kundërshtojnë një vlerësim apo një vendim të Komisionit Disiplinor brenda ATK-së. Ky komision është një shkallë tjetër brenda ATK-së i cili shqyrton kontestet dhe ankesat e zyrtarëve të ATK-së të cilët paraprakisht kanë kaluar nëpër procedura disiplinore nga Komisioni Disiplinor. Ky komision trajton edhe ankesat e palëve të treta që aplikojnë për punë në ATK dhe nuk janë të kënaqur me vendimet përfundimtare.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave përbëhet nga tre anëtarë me status të nëpunësit civil të punësuar në ATK, të cilët nuk mund të jenë të njëjtën kohë edhe anëtarë të Komisionit Disiplinor. Për adresimin e një çështjeje në këtë komision, pala e pakënaqur duhet të paraqesë ankesë me shkrim brenda një afati prej 30 ditëve nga momenti kur pala ka pranuar vendimin nga Komisioni Disiplinor. Në rast të zhvillimit të procedurës në këtë komision, sigurimi i provave bëhet nga njësia e personelit e cila në të njëjtën kohë bën edhe përgatitjet administrative për mbajtjen e takimit të komisionit. Takimi (seanca) duhet të mbahet brenda 10 ditëve nga dita e pranimit të ankesës derisa vendimi duhet të merret brenda 30 ditëve dhe pastaj pala njoftohet për vendimin brenda një periudhe prej pesë (5) ditëve.

Në mesin e mekanizmave që u përmendën deri tani, vija e komunikimit nga poshtë - lart ka këtë renditje: Divizioni i Standardeve Profesionale inicion një hetim dhe në bazë të rezultateve të hetimit, një rast kalon në procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor. Pastaj, nëse zyrtari ka ankesë ndaj masave të shqiptuara nga Komisioni Disiplinor, procedura vazhdon në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Nëse zyrtari në fjalë nuk pajtohet me vendimin e komisionit të fundit, procedura kalon në KPMSHC.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është institucionin i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, i cili për punën e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Funksionet e Këshillit janë të përqendruara në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civilë dhe aplikuesve për punësim në shërbimin civil të Kosovës, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislationit për shërbimin civil dhe vëzhgimin e zgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit drejtues dhe niveleve të njëjta në institucionet e Kosovës.

Këshilli përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit zgjidhen përmes konkursit të hapur dhe më pas emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit. Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar.

Në Këshill mund të ankohen të gjithë nëpunësit civilë të Kosovës dhe aplikuesit për punësim në Shërbim Civil të Kosovës.

Ata fillimisht duhet të shfrytëzojnë procedurën e brendshme të organit punëdhënës (fillimisht të ankohet, në komisionin e ankesave të autoritetit punëdhënës) e pastaj në Këshillin e Pavarur.

Shtojca 2: Vendimet e KPMSHC-së

Vendimi A.nr.762/18

Përmes këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka vendosur që ta aprovojë ankesën e Ankuesit R.A, dhe ta shfuqizojë vendimin e Komisionit për zgjidhjen e Kontesteve të ATK-së.

Me këtë vendim, Këshilli e ka detyruar Drejtorin e Përgjithshëm që inspektorin e lojërave të fatit ta kthejë prapë në pozitën e njëjtë pasi të njëjtit për shkak të përgjegjësisë disiplinore i ishte ndërruar pozita.

Komisioni Disiplinor në korrik të vitit 2017 zyrtarit i kishte shqiptuar masën disiplinore: "Largim nga Zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim gradimi prej 1 viti".

Zyrtari ndaj këtij vendimi ishte ankuar në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave mirëpo ankesa i ishte refuzuar për shkak se ishte paraqitur pas afatit.

Pas kësaj, ndaj masës disiplinore ishte ankuar edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, mirëpo kjo shkallë e kishte refuzuar ankesën e tij.

Pasi ishte pranë përmbushjes së masës disiplinore, zyrtari i ishte drejtuar ATK-së, duke kërkuar që të kthehet në pozitën në të cilën ka qenë sipas akt emërimit.

Pas kësaj kërkesë, ATK-ja e kishte njoftuar se e ka transferuar në Zyrat të Mbledhjes së Detyrueshme, me çka nuk ishte pajtuar zyrtari dhe kishte paraqitur ankesë në Komision për zgjidhje të kontesteve nga ku mori përgjigjen se ankesa e tij ishte e pabazuar.

Pasi kishte pranuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, zyrtari ka paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës ndaj këtij vendimi.

Duke vepruar sipas ankesës, Këshilli i Pavarur e ka vlerësuar si të bazuar ankesën e zyrtarit me të cilën i njëjti kërkonte të kthehej në pozitën "Inspektor i Lojërave të Fatit".

Këshilli vendimin e arsyetoi me Rregulloren Nr. 06/2010, në të cilën përcaktohet se "Pas kalimit të periudhës së transferimit të përkohshëm nëpunësi civil duhet të kthehet në pozitën paraprake".

Me këtë rast, Këshilli ka vlerësuar se zyrtari duhet të kthehet në pozitën sipas akt emërimit, pasi e ka përfunduar masën disiplinore.

Vendimi A.Nr. 378/2018

Përmes këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka shfuqizuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të ATK-së, dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim.

Në këtë çështje, zyrtari H.A, fillimisht ka parashtuar ankesë ndaj masës disiplinore "Qortim", të shqiptuar nga Drejtori i Departamentit për Tatimpaguesit e Mëdhenj për shkak të vonesës së realizimit të kontroleve.

Lidhur me këtë masë, zyrtari kishte paraqitur ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Duke vepruar sipas ankesës së zyrtarit, komisionit e ka refuzuar ankesën si të pabazuar.

Pas pranimit të këtij vendimi zyrtari paraqet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

Këshilli i pavarur Mbikëqyrës pas pranimit të ankesës dhe shqyrtimit të saj ka vlerësuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe nuk i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit.

Andaj duke vlerësuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si të paqartë dhe të pakuptimtë me një arsytim të pamjaftueshëm se a ka pasur përgjegjësi zyrtari në fjalë për mos-zbatim të planit të punës, në mënyrë që të konstatohet faji i ankuesit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e ktheu vendimin për rishqyrtim.

Vendimi A. 702/2018

Me anë të këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka vendosur ta refuzojë ankesën e zyrtarit të ATK-së, B.D, dhe njëkohësisht ta refuzojë vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Komisioni Disiplinor ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim gradimi për periudhën 2 vjeçare".

Pas vendimit të fjalë, Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, ka vendosur që ta transferojë zyrtarin në fjalë në pozitën Inspektor Tatimor në Drejtorinë Rajonale në Mitrovicë, duke e zbatuar kështu vendimin e Komisionit Disiplinor.

Mirëpo një vit më pas përmes një e-mail, zyrtarja e Burimeve Njerëzore e ka njoftuar zyrtarin se e kanë transferuar nga Inspektori Tatimor në Mitrovicë në pozitën Inspektor Tatimor në Drejtorinë Rajonale Prishtina 2.

Lidhur me këtë vendim, zyrtari në fjalë ka paraqitur ankesë te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave,.

Duke e trajtuar ankesën, Komisioni ka venduar që të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar në ligj.

I pakënaqur me këtë vendim, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës duke kërkuar që të kthehet në pozitën sipas "Akt Emërimit".

Duke e shqyrtuar lëndën në fjalë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka konstatuar se masa disiplinore ndaj tij është caktuar 20 korrik 2017, me kohëzgjatje prej 2 vitesh, dhe duke u bazuar në këtë, Këshilli e ka refuzuar kërkesën e tij për ta kthyer në pozitën sipas akt emërimit për shkak se masa disiplinore është akoma në fuqi.

Këshilli ka vlerësuar po ashtu se transferimi i tij nga Inspektori Tatimor në Mitrovicë në Inspektorin Tatimor në Prishtinë 2 është i kundërligjshëm pasi që organi i punësimit nuk ka të drejtë të nxjerrë akt tjetër lidhur me transferimin e nëpunësit deri sa të përfundojë masa disiplinore.

Duke e parë këtë, Këshilli e ka shfuqizuar vendimin e komisionit të ankesave për shkak se ka vlerësuar se komisioni i ankesave nuk e ka shqyrtuar fare ankesën e inspektorit tatimor dhe ka vendosur pa e konstatuar gjendjen faktike.

Në këtë mënyrë e ka lënë në fuqi vendimin e drejtorit të përgjithshëm për transferim në pozitën Inspektor Tatimor në Drejtorinë rajonale Mitrovica 2.

Vendimi A.nr. 564/2018

Me anë të këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e ka aprovuar ankesën e zyrtarit R.Ç, duke e kthyer kështu në vendin e punës në të cilin ishte para se Drejtori i Përgjithshëm ta transferonte në pozitën e Inspektorit të mbledhjes, duke e shfuqizuar kështu vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe të Komisionit të Kontesteve dhe Ankesave.

Ankuesi në fjalë, sipas "Akt Emërimit", është në pozitën e Udhëheqësit të ekipit të kontrollit në Prizren, mirëpo me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, nga kjo pozitë ishte transferuar në Udhëheqës të Ekipit të mbledhjes së Detyrueshme.

I pakënaqur me këtë vendim, ai kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili ia kishte refuzuar ankesën si të pabazuar.

I pakënaqur me këtë vendim, ankuesi paraqet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës me pretendimet se vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm është në kundërshtim me Ligjin mbi Shërbyesit Civilë dhe rregullores për transferim të nëpunësve civilë për faktin se në vendim të drejtorit nuk janë përcaktuar lloji i transferimit i përhershëm apo i përkohshëm e as afati kohor i zgjatjes së vendimit.

“Sipas ligjit mbi shërbyesit civilë, zyrtarët e lartë drejtues mund të caktohen në pozita të ndryshme me gradë ekuivalente për një periudhë të caktuar kohore por jo më shumë se 6 muajt”.

Po ashtu pretendimet e ankuesit janë se transferimi në fjalë është bërë pa kërkesën e udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe nuk është e arsyetuar.

Ligji mbi Shërbyes Civilë e përcakton se “Kërkesa për transferim duhet të bëhet nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i njësisë dhe duhet të jetë i arsyetuar”.

Andaj duke vendosur sipas anekses, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës gjeti se vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm është në kundërshtim me ligjin dhe vendosi ta aprovojë si të bazuar ankesën duke e detyruar Drejtorin e Përgjithshëm të ATK-së, që ta kthejë në pozitën e njëjtë të punës që ka qenë para transferit.

Vendimi A. 562/2018

Me anë të këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e ka refuzuar ankesën e zyrtares F.A. duke e vërtetuar kështu vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së. Këshilli i pavarur Mbikëqyrës e ka vërtetuar përgjegjësinë disiplinore të zyrtare F.A. dhe e ka lënë në fuqi masën “Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion me detyra të ngjashme dhe ndalim gradimi për një periudhë 3 vjeçare”.

Ankuesja duke e kundërshtuar këtë masë të komisionit disiplinor ishte ankuar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili e kishte refuzuar ankesën e saj si të pabazë.

Pas kësaj, zyrtari i ishte drejtuar me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës me pretendimet se vendimi është shqiptuar në kundërshtim me Ligjin mbi Shërbyesit Civilë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës duke vendosur sipas ankesës, pasi i ka shqyrtuar të gjitha dosjet e lëndës e ka gjetur të pabazuar Aneksen e zyrtares F.A. dhe e ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Ankesave pasi e ka vlerësuar se vendimi në fjalë dhe masa e shqiptuar është konform dispozitave ligjore dhe i mbështetur në prova.

Ankueses në fjalë i është shqiptuar masa disiplinore pasi është vërtetuar se në orët e vona të natës ka bërë telefonata ka dhe ka dërguar SMS-ë fyes dhe ofendues te koleget duke ua cenuar kështu jetën personale të tyre. Andaj në bazë të Ligjit për Shërbyes Civilë asaj i është shqiptuar masa në fjalë.

Vendimi A.nr. 380/2018

Përmes këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e ka shfuqizuar vendimin e Komisionit të Ankesave dhe e ka kthyer për rivendosje vendimin e komisionit me arsyen se vendimi i komisionit nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike.

Fillimisht Drejtori i Departamentit për Tatimpaguesit e Mëdhenj kishte shqiptuar masën disiplinore "Qortim", ndaj ankuesit S.D. për shkak të vonesave të realizimit të kontrolleve nga inspektorët e tij.

Duke e kundërshtuar masën në fjalë, zyrtari kishte paraqitur ankesë në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave mirëpo ankesa në fjalë ishte refuzuar si e pabazuar.

Pas këtij vendimi ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës duke pretenduar se nuk është vërtetuar përgjegjësia e tij.

Duke vendosur sipas ankesës së palës dhe përgjigjes në ankesë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka vlerësuar se vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk është i bazuar për shkak se nuk janë marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e ankuesit.

Sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës, Komisioni i Ankesave në rishqyrtim duhet të konstatojë gjendjen faktike dhe përgjegjësinë e ankuesit për shkak se masa ndaj tij është shqiptuar edhe për planin e punës për të cilin nuk ka pasur përgjegjësi fare ankuesi për menaxhimin e atij ekipi.

Andaj me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike Këshilli gësjtjen e ka kthyer në rishqyrtim.

Vendimi A.nr. 485/2018

Përmes këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka aprovuar ankesën e ankueses F.D. dhe e ka anuluar procesin e rekrutimit për pozitën zyrtar i Mbledhjes së Detyrueshme (5 pozita).

Fillimisht, pas përfundimit të procesit të rekrutimit për pozitën në fjalë ishin pranuar 5 persona. E pakënaqur me këtë vendim, F.D. kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave mirëpo nuk kishte marrë përgjigje nga ky komision dhe me këtë rast kishte parashtruar ankesë kundër heshtjes administrativeve në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

Duke vendosur sipas ankesës dhe përgjigjes në ankesës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka konstatuar se pas procesit të rekrutimit kandidatë të suksesshëm kishin dalë tre persona të cilat nuk i plotësonin kriteret e konkursit.

Duke u bazuar në këtë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka vendosur që ta anulojë konkursin.

Vendimi A.nr. 757/2018

Me anë të këtij vendimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e ka shfuqizuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe e ka kthyer vendimin për rivendosje.

Ankuesja Sh.Sh. ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm për transferim nga pozita "Analiste e Sistemit të TI", në një pozitë tjetër në Divizionin për Zhvillim të Aplikacioneve Biznesore në vendin e punës te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, mirëpo kërkesa i është refuzuar si e pabazuar.

Pas kësaj, ankuesja i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës duke pretenduar se vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm nuk është në përputhje me ligjin.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e ka gjetur të bazuar ankesën e ankuseses pasi që gjeti se vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm është mbështetur gabimisht në nenin 28 të Ligjit mbi Shërbyesit Civilë i cili nuk e përbën bazën ligjore për rastin në fjalë, dhe në këtë mënyrë Drejtori është dashur që transferin në fjalë ta bëjë duke u përputhur dispozitat e rregullores për transferimin e nëpunësve civilë.

Andaj duke e pasur parasysh që vendimi i tillë është bërë pa e përcaktuar llojin e transferit dhe kohëzgjatjen e tij si dhe faktin se nuk është marrë fare parasysh pëlqimi i ankuseses, Këshilli ka vendosur që çështjen ta ktheje në rishqyrtim.

Vendimi A.nr. 381/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës me anë të këtij vendimi e ka shfuqizuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe rastin ia ka kthyer për rishqyrtim.

Në këtë rast, ankuesi B.I. ka paraqitur ankesë kundër Drejtorit të Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj i cili i ka shqiptuar masën disiplinore "Qortim" për shkak të vonesave në kryerjen e kontrollit.

I pakënaqur me këtë vendim, ankuesi ka paraqitur ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, komision i cili ka marrë vendim që t'ia refuzojë ankesën.

Pas kësaj B.I. i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i cili pas administrimit të provave ka vlerësuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk i ka marrë për bazë fare pretendimet e ankuesit.

Këshilli ka kërkuar të rishqyrtohet ankesa në mënyrë që të shikohet se masa e shqiptuar nga Drejtori i Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj a është shqiptuar brenda afatit të paraparë me ligj.

Arsyetimi i Vendimit nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është vlerësuar si i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës dhe i pakuptueshëm, andaj Këshilli ka vendosur që vendimin t'ia dërgojë edhe një herë për rishqyrtim.

Duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga zyrtarët e ATK-së, kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka marrë aktvendim për ta kthyer në rishqyrtim vendimin në katër raste.

Shfuqizohet vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave dhe çështja i kthehet komisionit për rivendosje në mënyrë që të vërtetohet gjendja faktike.

Shfuqizohet vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave dhe çështja i kthehet komisionit për rivendosje në mënyrë që të vërtetohet gjendja faktike.

Shfuqizohet vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave dhe çështja i kthehet komisionit për rivendosje në mënyrë që të vërtetohet gjendja faktike.

Shfuqizohet vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave dhe çështja i kthehet komisionit për rivlerësim të transferim.

Shtojca 3

Tabela e raportimeve dhe mënyrës së zgjidhjes së rasteve burimi ATK

Regjionet	Nr. i thirrjeve në linjën online	Nr. i rasteve të dërguar në zyrat përgjegjëse	Nr. i aktiviteteve kthyesë	Nr. i gjobave të lëshuara nga regjionet lidhur me thirrjet online	Shuma e gjobave	Shuma e Qarkullimit Shtesë
DTM	6	6	5	2	2,000	0
Prishtina 1	30	30	20	15	3,295	0
Prishtina 2	26	26	29	35	12,625	0
Prishtina 3	46	46	39	16	8,379	1681.4
Prizren	29	29	29	21	4,925	0
Pejë	20	20	14	7	1625	0
Gjakovë	7	7	10	9	1375	0
Ferizaj	18	18	11	6	1000	0
Gjilan	11	11	16	8	1375	0
Mitrovicë	18	18	16	10	1,500	0
Lojrat e Fatit	93	93	61	37	152,500	0
Totali	315	315	257	166	190,599	1,681
NJHT	5	5	2			
DSP	4	4	4			
Dogana	1	1	1			
Edukimi	1	1	1			

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

336.2(496.51)"2018/2019"

Egzona Kozhani

Raporti i monitorimit të integritetit në administratën tatimore në Kosovë : shtator 2018-shkurt 2019/ Egzona Kozhani, Kastriot Berisha. – Prishtinë : Democracy Plus, 2019. – 40 f. : ilustr. ; 21 cm.

1. Berisha, Kastriot

ISBN 978-9951-758-15-4

shtator 2018 – shkurt 2019



ISBN 978-9951-758-15-4



**Realizimi i këtij hulumtimi është mbështetur nga
Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.
Qëndrimet në raport nuk paraqesin qëndrimet e
Ambasadës dhe Qeverisë Britanike.**



British Embassy
Pristina



DEMOCRACYPLUS